**AKT-THEMELIMI**

**I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ESKLUZIV" RRESHEN**

Sot me daten 25.4.1994 u paraqit personalisht z.Rexhep Izet Ruçi lindur me 20.3.1951 ne Kukes dhe banues ne Rubik,me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili me vullnetin e tije te lire,kerkoji te themeloje shoqerine"Eskluziv" ne perputhje me kete akt,statutin e shoqerise dhe duke respektuar kerkesat e ligjeve te shtetit shqiptar.

Mbi bazen e ketij akti z.Rexhep Ruçi vendosi:

1.Te themeloje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar e cila emertohet "ESKLUZIV"

2.Shoqerija do te kete seline e saj ne Rreshen ne adresen:Qyteti Rreshen-Mirdite.Ajo do te kete te drejten te hape filiale edhe ne qytete te tjera te vendit.

3.Shoqerija do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat prej 10 vjetesh,ne qofte se nga themeluesi i shoqerise nuk do te merret ndo nje vendim tjeter i cili do teshoqerohet edhe me ndryshimet perkatese ne statut.

4.Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete prodhimi i materialeve te ndertimit,shitja me shumice e me pakice,import eksporti i tyre si dhe ndertimi montimi i objekteve.

5.Kapitali i shoqerise do te jete 100.000 leke i cili i perket totalisht themeluesit te shoqerise z.Rexhep Ruçi.Fitimi i rrjedhur nga aktiviteti i shoqerise do te jete prone e z.Rexhep Ruçi i cili do ta perdore ate si per zgjerimin e prodhimit ashtu edhe per rritjen e konsumit individual e nevoja familjare.

6.Administrator i shoqerise "Eskluziv " do te jete z. Gjon Nobrejo.

Per sa me siper themeluesi i shoqerise eshte dakort dhe e firmos aktin e themelimit te shoqerise.

REXHEP IZET RUÇI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
N O T E R I A
790

Rreshen me 25.4.1994

V E R T E T I M

Sot me daten 15.5.1994,para meje noteres u paraqit themeluesi i shoqerise "ESKLUZIV" Rexhep Ruçi,banues ne Rubik,me zotesi te plote per te vepruar,njohur pesrsonalisht prej meje dhe duke qene dakort me aktin e themelimit e nenshkruan ate para meje noteres.

N O T E R E
VITORE BIBA

# S T A T U T

## I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " ESKLUZIV " RRESHEN.

## KAPITULLI I PARE

### Dispozita te pergjitheshme

#### Neni 1

Shoqerija tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ESKLUZIV " eshte person juridik shqiptar.Ajo ushtron veprimtarine e saj private ne perputhje me kerkesat e ekonomise tregut lire,duke respektuar normat ligjore te percaktuara ne kete fushe me ligjin Nr.7638 date 12.11.1992 "Mbi shoqerite tregtare" ligjet e tjera te shtetit shqiptar dhe aktet e percaktuara ne kete statut.

#### Neni 2

Shoqerija tregtare "ESKLUZIV " themelohet nga z.Rexhep Ruçi, banues ne qytetin e Rubikut.Vendndodhja e shoqerise do te jete me qender ne Rreshen.Ajo do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje kohe prej 10 vjetesh me te drejten e rizgjatjes se afatit.

#### Neni 3

Te drejten e personit juridik shoqerija e fiton nga data e rregjistrimit te saj ne gjykate.President i kesaj shoqerije eshte z.Rexhep Ruçi dhe administrator i shoqerise z. Gjon Ndrepa

#### Neni 4

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 Njeqind mije leke dhe eshte teresisht ne pronesi te z.Rexhep Ruçi.

#### Neni 5 Objekti

Shoqerija tregtare me pergjegjesi te kufizuar "ESKLUZIV" do te ushtroje veprimtarine e saj ne fushen e prodhimit te materialeve te ndertimit,shitjen e tyre me pakice e me shumice,import eksporti i tyre si dhe ndertim montimi i objekteve.

#### Neni 6

Shoqerija tregtare "ESKLUZIV" ka te drejte te çele filiale te saj ne qytetet e tjera te Shqiperise,duke respektuar legjislacionin perkates shqiptar.

## KAPITULLI I DYTE

### Maredhenjet ekonomike e financiare

#### Neni 7

Veprimtarija e shoqerise realizohet ne mbeshtetje teveprimtarise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj.

#### Neni 8

Per te zhvilluar veprimtarine e saj shoqerija ka te drejte te çele llogari rrjedhese prane bankave te ndryshme shtetrore apo pri

vate,ne leke dhe ne valute te huaj.

Neni 9

Shoqerija ka te drejte te disponoje e perdore pasurine ne perputhje me qellimet e objektivat e shoqerise e te veprimtarise saj.Ajo gezon te drejten e mbrojtjes se pasurise sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 10

Shoqerija mund te lidhe kontrato me persona juridike vendas e te huaj duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

Neni 11

Pasurija e shoqerise pasqyrohet ne bilancin e saj te shprehur ne monedhe shqiptare ose kur eshte rasti edhe ne monedhe te huaj ne perputhje me dispozitat ligjore perkatese.

Neni 12

Si rregull bilanci vjetor mbi aktivitetin e shoqerise paraqitet brenda muajti Mars te vitit pasardhes dhe keshtu veprohet per çdo vit. Bilanci vjetor mbeshtetet ne raportin e perpiluar nga ekspertet kontabel te ngarkuar per kete qellim.

Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike zbatohet,konform rregullave te percaktuara ne aktet ligjore.

Neni 13

Kapitali fillestar i shoqerise eshte burimi fillestar per krijimin e fondeve te veçanta dhe te xhiros.Kapitali themelor i shoqerise eshte lehtesisht i transferueshem me rruge trashegimie dhe brenda familjes.Ne rast se ne te arthmen shoqerija do te kete edhe ortake te tjere transferimi mund te behet edhe ndermjet ortakeve dhe ne persona te trete kurdo here me marrveshjen e ortakeve.Vendimi merret me miratimin e shumices se ortakeve qe do te perfaqsojne 3/4 e pjeseve te kapitalit themelor.

Neni 14

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Ben perjashtim viti i pare i cili pavarsisht nga data e fillimit do te mbyllet me 31 Dhjetor.

Llogarite vjetore,inventari,raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta te hartuar nga administratori dhe ekspertet kontabel si rregull i pergjithshem miratohen nga asambleja me vendim te ortakeve qe zoterojen ½ e kapitalit themelor.Ne kushtet ekzistuese te kesaj shoqerije miratimi do te behet nga presidenti i shoqerise.Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 15

Pas llogaritjeve fitimi ndahet nepermjet ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar.Ky raport baspektohet ne çdo rast me per jashtim kur ortaket bien dakort ndryshe.Ne kushtet ekzistuese fitimi kal on ne llogari te pronarit.

Kur shoqerija pushon veprimtarine e saj,pasi shlyen detyrimet nd aj te treteve,pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurave ndahet midis o ortakeve ne proporcion me kuotat e depozituara te kapitalit themeltar,ne qofte se nga ortaket nuk eshte vendosur ndryshe.Ne rastin konkret pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurave mbetet ne llogari te pronarit veten

KAPITULLI I TRETE

Organizimi dhe drejtimi administrative

Neni 16

Drejtimi i shoqerise behet nga presidenti i shoqerise dhe kur ka ortake,prej tyre.Ai ose ata vendosin per shtimin ose paksimin e kapi talit themelor te shoqerise,per likujdimin e veprimet e tjera financiare per ndryshimin e formes se shoqerise si dhe per pushimin e veprimtarise saj ( para afatit) etj.kompetence te cilen ne shoqerine me ortake e ka asambleja dhe ne kushtet e nje ortaku te vetem e ka presidenti i shoqer se.

Neni 17

Presidenti i shoqerise z.Rexhep Ruçi gezon te drejten e perfaqs mit te saj dhe te nenshkrimit.Kete te drejte presidenti i shoqerise mu nd t'ja delegoje edhe administratorit z. Gjon Ndreja.

Administratori kryen te gjitha veprimat e administrimit ne inte es te shoqerise.Ai nuk mund te kaperceje kompetencat e percaktuara me ligj dhe ne kete statut.Administratori pergjigjet vete per veprimet qe jane kryer prej tije ne kundershtim me ligjet dhe interesat e shoqeris si rezultat i te cilave asaj i eshte shkaktuar dem.

Neni 18

Veprimet e marra nga shoqerija rregjistrohen ne librin e shoqe ise i cili eshte i posaqem.

Neni 19

Maredhenjet e punes me punonjesit qe punesohen rregullohen me kontrate individuale te cilat rregullohen veçmas per çdo punonjes.

KAPITULLI I KATERT

Riorganizimi dhe pushimi i veprimtarise

Riorganizimi dhe pushimi i veprimtarise eshte nje e drejte eks kluzte e presidentit te shoqerise ose e ortakeve ne se ne tearthmen d shtohet numuri i tyre.

**Neni 21**

Veprimtarija e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te caktuar. Per zgjatjen e afatit duhet te behen ndryshimet perkatese ne statut.

**Neni 22**

Prishja e shoqerise behet ne rruge gjyqesore sikurse parashikohet me ligj.Kur shoqerija pushon veprimtarine e saj si rregull ekspertet e ngarkuarpregadisin raportin kontabel per njohjen e gjendjes financiare me qellim qe te shlyhet detyrimi ndaj te treteve dhe po qe se ai ekziston edhe per ndarjen e fitimit.Shoqeija pushon veprimtarine e saj kur kjo çmohet nga presidenti i shoqerise ose nga asambleja e ortakeve.

**KAPITULLI I PESTE**

**Dispozita te fundit**

**Neni 23**

Per sa nuk parashikohet ne kete statut,zgjidhet ne baze te rregu llave te pergjithshme e dispozitave te parashikuara me ligj.

Ky statut hyn ne fuqi me krijimin e shoqerise.Presidenti i shoqer ise eshte dakort me perubajtjen e saj.

REXHEP IZET RUÇI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
N O T E R I A
790

Nr______Rregj.

**V E R T E T I M**

Sot me daten 25.5.1994 para meje noteres u paraqit se Rexhep Izet Ruçi president i shoqerise "Eskluziv" ne krijim e siper i lindur ne Kukes me 20.3.1951 dhe banues ne Rubik,me zotesi te plote per te vepruar,madhor,i njohur personalisht prej meje duke qene dakort me statutin,me vullnetin e tij te lire e nenshkroji ate para meje noteres.

N O T E R E
VITORE BIBA